NJË STUHI PREJ BRYME

Shtëpia botuese “Trend - Prishtinë
2018

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Redaktor:
Luan KURTI

Recensent:
Luan KURTI

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Bashkim Alushi

NJË STUHI PREJ BRYME

Shtëpia botuese “Trend”- Prishtinë
2o18

Një vështrim mbi librin poetik "Një Stuhi prej Bryme", të autorit Adem ZAPLLUZHA.

Luan KURTI

Moderniteti si shfaqje e globalizmit ka krijuar një kundërvënie të hapur ndaj tradicionales në të gjitha llojet e kuptimeve. Por pavarësisht kësaj arti i bukur gjithmonë ka gjetur rrugën për t'u afirmuar, për të përcjellë frymën më pozitive të kohës kur ngjizet. Teoria e "Arti për Art" është kaq e vjetër, sa edhe e re dhe e shumëdebatuar. Disa teoricien, kritik arti përpiqen ta shohin krijimtarinë dhe Autorin domosdoshmërisht si të lirë, të shkëputur nga çdo lloj rregulli, norme letrare, si të pandikuar nga nevoja e publikut, në një liri të tërësishme ku ai (autori) realizon unin e vetë dhe nuk kërkon aprovim. "I vjen dhe e shkruan' dhe tek ky spontanitet sipas tyre, qëndron vlera reale, autenticiteti. Por

“Arti për art” në kuptimin më klasik ka qenë fokusuar në qasjen e një “arti pa shpirt” që mëton shumë e nuk thotë asgjë, një lloj relikti që nuk i hyn në punë askujt, e një mjeti, apo artefakti memec si hieroglifët. Letërsia e sotme përpos arritjeve, ka një regres, varfëri tematike, priret më tepër drejt temave të lehta, rozë, që të jetë e shitshme sipas logjikës së tregut. Merret me pasojën por jo me shkakun, operon me formën, me dukjen, por pak i kushton rëndësi përmbajtjes. Letërsia e sotme përgjithësisht kërkon dekodim, një lexues jo thjesht të specializuar, por sa më pak refleksiv që të konformohet dhe të mos merret me retorikë.
Por për të mos u zgjeruar në këtë lëmi, ku secili ka mendimin e vet dhe (letërsia është perceptim dhe shije individuale), le të themi dy fjalë për letërsinë shqiptare mbarëkombëtare. Thuhet se ka pasur një letërsi të ideologjizuar gjatë kohës së Luftës së

Ftohtë, këndej dhe andej kufirit, që i ka shërbyer diktaturave, por pas viteve 90 –të është shterpëzuar, s’’ka mundur t’i bëj ballë konkurrencës në tregje dhe të afirmohet. Disa dashamirë duke ju referuar handikapit botëror të rënies së interesit për librin, ku pragmatizmi kushtëzon materialen dhe ka braktisur shpirtëroren, për shkak edhe të teknologjisë, rendisin si faktor edhe “vendin e vogël”, “kombin e vogël” që rezonon automatikisht me “gjuhë të vogël”, e limituar për transit si gjuhët anglikane, latine apo gjuhë të tjera ,që ka një grusht lexuesish dhe mbetet një akt në tentativë, një dështim i paralajmëruar. Dhe kjo frymë, ky perceptim ka krijuar ndjenjën e inferioritetit, të gjunjëzimit ndaj së jashtmes dhe pranimit apriori të çdo lloj çorbe që na servirin disa prej botuesve të sotëm. Kemi në të vërtetë një masivizim, shpërthim frenetik të lirisë individuale, ku sekush shkruan,

këndon, aktron, një tallavaizëm që ka krijuar një treg të deformuar dhe informal që ka nxjerrë në plan të dytë dhe injoruar artin e vërtetë dhe kulturën kombëtare.

A kemi letërsi të mirëfilltë post–diktaturë, a kemi emra të denjë për të qenë konkurrent apo të barazvlefshëm për nga rëndësia me më kolosët e artit të sotëm bashkëkohor?...
Padyshim që po!
Njëri prej tyre, sipas këndvështrimit tim, është edhe autori i librit që vjen të prezantohet para auditorit të gjerë "**Stuhi prej bryme",** poeti i mirënjohur Adem Zaplluzha.
Koincidon emri i luftëtairt të lirisë, të çlirimit të Kosovës Adem Jashari me atë të autorit Adem Zaplluzha: luftëtar i dritës, i diturisë, i artit poetik origjinal, me frymë Kosove, me frymë Arbërore, Ilirike, që cek trojet tona etnike natyrale që na ka falur Zoti. Baca

Adem (ët) në një simbioz me pushkë dhe penë!
"Stuhi prej bryme" shënon librin e 152-të të poetit tonë Zaplluzha! E kush mund të thotë se është plakur, se mosha t'i shteron fuqitë? Kjo prodhimtari voluminoze nuk ka cak, rrjedh e gurgullon si ujëvarat prej shpateve të thepisura të maleve, si përrenjtë shkarrëzues luginave dhe lumenjtë e rrëmbyeshëm me ujëra të kristalta në shtretërit e tyre autokton që nga krijimi i botës. Kjo krijimtari është një enciklopedi më vete, e papërsëritshme!
Njëqind shekuj të prita/ si leckat e një këmishe/ sytë më mbetën në rrugë/ u shterën lumenjtë e shpresës/ askund nuk duket në horizont/ këmisha e grisur e kujtesës/.... (Me shterimin e zërit të mykur)
Nuk do të merrem shumë me teknikalitete të vargjeve, me analiza metrike apo të figuracionit, detyrë eskplicide e teoricienëve dhe kritikëve

letrarë, por me atë që është më esenciale në veprën e autorit që përbën tharmin dhe shpreh vlerën e tij të vërtetë poetike.
Autori shkruan e shkruan me durim prej spartani dhe ja del prore të mos bjerë në përsëritje, të mos imitoj askënd, të jetë origjinal duke e kthyer lëndën bruto prej realitetit në një produkt "Bio"me vlerë të gjithhershme. Ajo që bie në sy përpos shumësisë së veprave është larmia tematike. Autori i këndon dashurisë si vlerë universale, natyrës së vendlindjes, Atdheut të të parëve, përpjekjeve, sakrificave të heronjve të çdo kohe, ndjenjave më të holla humane, del jashtë kufijve real, hapësirës së prekshme dhe bëhet zëri i kohës vet, i një mirëkuptimi dhe solidariteti të përbotshëm, ku dallimet gjuhësore, racore dhe etnike nuk janë parësore.
Thënë përmbledhtas: lirik i ëmbël, romantik ëndërrimtar, epik i thekur,

dramatik- tragjik, filozofik, baladesk, që pjalmon lule më lule për të prodhuar mjaltin poetik. Që edhe prej pelinit të jetës së mundimshme, shpesh të padrejtë të krijojë idealin e një bote të paqtë, të dëlirë, në përputhje të plotë me aktin dhe qëllimin e krijimit.
Poeti Zaplluzha preferon vargun e lirë, pa korniza rimash, pa barriera rregullash të ngurta, por që në mënyrë mjeshtërore realizon një muzikalitet të brendshëm që ndjehet vijueshmërisht, ndjenjë dhe emocion, përjetim që të hyn thellë në shpirt e të bën "rob" të magjisë, të sugjestionit poetik, plot metafora dhe alegori kundërthënëse.
Sa jemi afër/ E sa larg njëri tjetrit; Unë në polin e Veriut...../ Kurse ti në anën e kundërt të hemisferës / ku vdesin fluturat/.....Nën hijen e cilit yll/ u mbarësua dhembja e fjalës.... (Vetëm zërat e mjegullave)
Një element i spikatur është gjuha e thjeshtë, e purifikuar nga alogjizmat,

fjalëformimet e reja që krijojnë një pasuri të paçmuar kombëtarisht. Karakteristike është mënyra se si e ndërton vargun, se si e merr lëndën prej realitetit të shumëfishtë fizik, ndjesor dhe përtejndjesor, abstragon duke e shndërruar në një motiv të qenësishëm. Vepra e tij është si një akt që s'mbaron, që e lë portën e hapur ku secili mund të hyjë pa trokitur, që flatron në sfond dhe të fton ta ndjekësh në udhën e qumështit të galaksisë poetike dhe ta plotësosh me parafytyrimin, imagjinatën, fantazinë, eksperiencën dhe dëshirën tënde të pakushtëzuar. Ne, shqiptarët, jemi edukuar t'i kërkojmë gjenitë jashtë vetes dhe ky është një handikap historik, të kemi frikë nga vlera mentale dhe të përpiqemi të lartësojmë vetëm atë fizike, dukjen që u imponohet të tjerëve dhe shitet si autoritet. Artistët, poetët, shkrimtarët, njerëzit e penës nuk emërohen me urdhra e dekrete, nuk i

përkasin establishmentit politik, por popullit të thjeshtë; ata lindin si të tillë dhe përsosen nëpërmjet punës së palodhur, titanike.
Poeti Adem Zaplluzha është një univers letrar me rrezatim të gjerë bashkëkohor. Ai i takon të djeshmes po aq sa edhe të sotmes, kur ngjiz lëndën e tij thjeshtësisht pa pompozitet, i veçuar prej turmës së potershme, duke u shndërruar në një profet të fjalës së lirë, pararendës, parathënës i së ardhmes, i fjalës së Zotit që i fton brezat të reflektojnë në kumtin poetik që përcjell; ai është Martaonomak i Lirisë, i Atdhedashurisë i pamvarësisë.
Qëndroj mbështetur në rrapin/ me trastën time të grisur në të cilën e mbaja bukën e përditshme/ dhe pak argjil nga Atdheu/.....Sëpata më shikonte me xhelozi/ Dhe dikur vonë më tha/ kur nuk je në gjendje ta gatuash njeriun/ nga shpirti i rrapit gdhende

qivurin tënd/..... (Që ngjan me perënditë e Olimpit).

"Stuhi prej bryme", një stuhi trazuese, momentale, që shkon me lindjen e ditës së re, me të dalë dielli dhe zbulon horizontin e paanë të një natyre magjike, që rizgjon shpresën, mirësinë, besimin tek triumfi i së mirës, i së bukurës, i së drejtës, të moralshmes dhe vërtetës, që të jep motivin për të jetuar në paqe dhe harmoni kudo dhe me gjithë kënd.
Nuk dua t'ju them lamtumirë/ ne gjithsesi/ do shihemi një ditë/..... (Nuk ka lamtumirë mes miqve).

Me këtë rast i uroj autorit Adem Zaplluzha suksese të mëtejshme në fushën e pasosur të krijimtarisë, që të nxjerr prej kafazit të kraharorit dhe brendisë së zemrës të tjerë pëllumba, të tjera dallëndyshe flatëronjëse drejt qiellit të Kosovës dhe shqiptarisë!

Cikli i parë

Një stuhi prej bryme

ME SHTERIMIN E ZËRIT TË MYKUR

Njëqind shekuj të prita
Si leckat e një këmishe
Sytë më mbetën nëpër rrugë
U shterën lumenjtë e shpresës
Askund nuk duket në horizont
Këmisha e grisur e kujtesës

Me shterimin e zërit të mykur
Desha të të thërras
Por ti nuk kishe emër
Dikush i mallkoi të gjitha parathëniet
Nëpër udhët e largëta të dynjasë
Mbetën vetëm kujtimet e hidhura

Në njëqind apo pesëqind kryqe
Një nga një i lidha kujtimet
I fsheha në një trastë
Të gjitha ëndrrat
Me fashat e lagura të lotëve
Mbështolla piramidën e dhembjes

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Unë ende jam duke pritur
Kur ti kthehesh
Ndoshta s’do e shohësh më
As hijen time të zhubravitur
Por gjithsesi te varret e vjetra
Vendos një zambak të verdhë
Vendos mu aty ku e sheh kryqin e vetmuar

VETËM ZËRAT E MJEGULLAVE

Sa jemi afër
E sa larg njëri-tjetrit
Unë në polin e Veriut
Ku më ngrihet loti në sy
Kurse ti
Në anën e kundërt të hemisferës
Ku vdesin fluturat e kaltra

Këtu dielli lind çdo shtatë vjet
Hëna askurrë nuk duket në horizont
Yjet klandestin i lajnë sytë
Me trishtimin e erës
Vetëm zërat e mjegullave
Dëgjohen në shpirtin e përroit
Kur shterojnë lumenjtë e dhembjes

Nën hijen e cilit yll
U mbarësua dhembja e fjalës
Kur gjëma e zezë
E Drinit të Bardhë
I krihte thinjat lapërdhare të flokëve
Në shtërzimin e brigjeve
Qante një nuse fatin e djepit

AS ME DIZGJINËT E ERËS

Ishte nata e parafundit
E njëmijë e një netëve
Kur fliste në ekstazë
Për puthjen e princit

Ajo rrëfehej para oltarit
Kurse zemra e tij
Si koka e prerë e pulës
I kërcente në kraharor

Papritmas doli në hapësirë
Dhe kurrë më
As me dizgjinët e erës
Nuk pat njeri që mund ta frenonte

Më pastaj çdo gjë u shndërrua
Në hi e pluhur
Një zog i vetmuar
Kurrë më s’e gjeti çerdhen e humbur

NJË STUHI PREJ BRYME

Pështyj në qiell
Kallkan akujsh më dalin nga gryka
Çfarë të bëj me duart e mia
Që s'mund ta përqafojnë
As drurin e zgërlaqur në shtrojerë

Ky dimër mbase na lodhi sivjet
I shkundi ullinjtë
Asnjë pemë nuk lë në këmbë
Nga çatitë e shembura të komshinjve
Si rrëshira pjalmon një borë e zezë

Ju lutem m'i prekni duart
Këto kocka të thyera
U ngjajnë drurëve të kalbura
U ngjajnë gurëve të mykur
Dhe algave që kundërmojnë

Më ndjeni kam të ftohtë
Nga zgërbonja e shpirtit tim
Fryjnë erërat e çmendura të Ballkanit
Një stuhi prej bryme
Frynë me tërë forcën e trishtimit

AJO E LASHTA VIA EGNATIA

Më duket se ishte sterrë
Nuk arrita t'i shoh duart e mia
Asnjë lule nuk më doli parasysh
Gjërat më dukeshin
Si arkivole të harruara
Ose stiva drurësh të kalbur

Në kopsht nuk dukeshin pemët
Ishin shkulur kujtimet
Nga sytë e shterur
S'pikonte asnjë trishtim
Mbase edhe nuk ndjenin atë etje
Ishin të topitur si hanxharët e një beteje

As njerëz nuk pashë nëpër rrugë
Udhët ishin mbushur
Me arabatë arkaike
Ajo e lashta Via Egnatia
I ngjante gjarprit të ngordhur
Pemët e thara nuk më shikonte me sy

ASKUND NJË COPË TOKË

Kuptova se kishte shumë të vrarë
Por nuk arrita të shoh
Asnjë kufomë
Me batanije kuajsh
I kishin mbështjellë njerëzit

Fërshëllima e trenit të çmendur
S'pushonte në fushën e mëllenjave
Edhe marsi ishte i tillë
Përroi i të paemrit
Uturinte si deti i tërbuar

Asnjë flamur nuk e pashë rrugëve
Sa pak njerëz kishte mbetur në qytet
Varret dukeshin lakuriq
Marsi i egër
I kishte djegur edhe kryqet e drunjtë

Askund një copë tokë
Për të vdekurit
Treni i Bllacës qante me ngashërim
Qanin edhe traversat

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Një mbrëmje e acartë mbeti peng në qytet

KISHTE VDEKUR EDHE VJESHTA

Qyteti i ngjante korit memec
S'dëgjoheshin zurnatë
Edhe lulet kishin vdekur
Kurse unë në rojën e mortit
Përqafoja kondakun e ftohtë

Një heshtje e tunxhtë
Dëgjohej si muzika e vrarë e luleve
Përtej korridorit
Pasqyrat e qytetit i kishin lëshuar flamujt
Në gjysmë shtizë

Rrugicave kalonin kukullat e dehura
Ngjyrat e neoneve
Pështynin kalimtarët e vonuar
Kurse varfanjakët në vitrinën e një furre
Ngopeshin me aromën e bukëve të nxehta

Shiu i spërkaste gjethet e fishkura
Kishte vdekur edhe vjeshta
Dimri veç dukej si një ngordhësirë
Çdo gjë në këtë qytet
Ishte shtrirë në qivurin e vdekjes

Prishtinë, 4 janar 2017

KUDO LULE TË KËPUTURA NË SHPIRT

Kur bien shirat e hidhura këtu
Zogjtë ikin të lagur tej malit
Ikin për t'i harruar stërkalat
Shirat që u përngjajnë lotëve
Duken vetëm një herë në vjeshtë

Ju thashë se kur bien shirat
Zogjtë e trembur
Nuk i shohim mbi telat e kujtesës
Me nga një grusht tokë deltine
Largohen nga atdheu

Marrin çdo gjë me vete
Kujtimet e mira
Dhe ato që nuk janë të mira
Por gjithsesi
Janë kujtime që duhet të stivohen në mendje

Edhe mbrëmë ngjau si herëve tjera

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

U përzien shirat dhe kujtimet
Kudo gjak në imagjinatë
Kudo lule të këputura në shpirt
Era mbi një kep prej dallge rrinte kacule
KAFSHONTE LËVOREN E DRURIT

Mos më bëj të ndjehem i vetmuar
Kjo ekstazë e dhembjes
Nuk paska shërim
Nga sytë e portokalltë të ditës
Pikojnë ullinjtë e atdheut tim

Ishin kohërat kur për një tramak misri
Njeriu shndërrohej në bishë
Kafshonte lëvoren e drurit
Kur në oxhak zihej guri i murrmë
Kafshonte me tërë tërbimin e shpirtit

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Kurse rrugët e boshatisura
Me nostalgji shikonin kalldrëmet
Nën çizmet e të huajve
Gurtë shndërroheshin në pluhur
Kalaja veç e kishte humbur krenarinë
NE NUK DASHURUAM ASNJËHERË

Nuk di a thua vallë ishim të lumtur
Ose na mundonte pikëllimi
Ne s'deshëm asnjëherë njëri - tjetrin
Për ne dashuria ishte një nocion i largët

Nën hijet e pemëve i shikonim vashat
Ju thashë vetëm i shikonim
Dashuria ishte një mollë e ndaluar
Sa që kushtonte me shtrenjtë se jeta

Dikush kishte guxim të kafshojë
Sepse të përkëdhelurit
Kurdoherë ishin në gjendje të përkëdhelin
Dhe të bëjnë çfarë të donë

E ne që ishim në anën tjetër të lumit
Vetëm shikonim dhe i matnim me sy
Fluturimet e fluturave
Të vrara e të gjakosura në shpirt

JU THASHË SE NJË DITË

Një ditë ndoshta është koha
Që nesër të nisem deri te varet
Ku më presin gjyshërit
Ndoshta do e gjej
Djepin tim të gdhendur

Njerëzit janë si elefantët
Presin çastin e duhur
Dhe u drejtohen varreve
Të shenjta
Nga ku nuk ka më kthim

Ju thashë se një ditë
Do të nisem udha është e gjatë
Pale se çfarë pengesash dalin në rrugë
Andaj na duhet
Sa më herët të marrim udhë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Të ecim pa u ndalur
Deri atje ku nuk ekziston kthimi
Ku njerëzit janë pa emra
Ku hijet mortore kanë një tjetër formë
U ngjajnë shpresave që kurrë s'u plotësuan

KURSE MBRAPA SI TË KTHEHEM

Ka kohë që nuk u takova
Me ëndrrën time
Isha tejet i vetmuar
Më bishtnonin puthjet e verbëta

Netët ishin shumë të largëta
Duhej ecur me mija vjet
Që ta takoj vetveten
Dhe puthjen e stuhisë

Sa herë që desha të eci
Pengesat ishin të panumërta
Një plep i kalbur
Gjithmonë shembej mbi kokën time

Ndoshta nuk e njohe ecjen time
Hyra nëpër ato rrugë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ku nuk ekzistonte dalja
Dhe asnjëherë s'pashë dritë përtej meje

Ja pra deri ku kam mbërri
Ose jam ndalë si derri i egër në akull
S'mund të eci përpara
Kurse mbrapa si të kthehem

I PASHË EDHE ANIJET E FUNDOSURA

Çfarë të bëj sonte
Me lotët e cilit trishtim
T'i qajë lulet e dhunuara
Ishte marsi i çmendur
Ndoshta edhe janari
Por gjithsesi ishte një kohë e egër

Nëpër rrugë hasa flamuj të grisur
Kuaj pa frena
Shalat kishin mbetur
Peng në logun e mejdanit
Kurse nga përroi i zanave

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Dëgjohej gjema e uturimës së detit

I pashë edhe anijet e fundosura
Marinarët duke bartur tmerrin
Në kockat e thyera të duarve
Balenën e helmuar
Gra që i shkulnin flokët e thinjura
Pashë edhe shamitë e gjakosura të frikës

DETI I TRAZUAR I SHPIRTIT

Njeriu gjithmonë mendon
Se i prinë fatit të vet
I prinë si një hije që rri para nesh
Por kur e përjeton të kundërtën
Këndellet si këndesi i dehur

Futi duart e tu të brishta
Në xhepat e mia
Futi
Në daç të shohësh vetveten
Në një formë të lëngët

Kjo lojë e vjetër
Zgjat me qindra vjet
Shikojmë njëri-tjetrin

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Dhe nëpër korridore i kërkojmë
Duart tona të fishkura

Më duket se të tregova mbrëmë
Se çfarë forme kishin fjalët
Por ti jo që nuk më besove
Por nuk ishe në gjendje
T'i besosh askujt e as vetvetes

Andaj ike përtej shtatë lumenjve
Shtatë herë gjëmoi
Deti i trazuar i shpirtit
Kurse ti mbete po ajo grua
Me vetëbesimin tënd të shthurur
Prishtinë, 5 janar 2017

HIRI I KUJTESËS

Si një mbret i çmendur zbret thëllimi
Nga ana e majtë e kujtesës
Lodrojnë kuajt e egër
Kurse nga e djathta
Dëgjohen hingëllimat e mjegullave

Çdo gjë e plumbtë përreth meje
Hiri i kujtesës
Ka kohë që fle në hinoren time
I kujt është ky qivur
Kush ju tha se mbrëmë më vdiqën duart

Një ankth i paparë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Paraqitet me ëndrrat e mia
Por unë s’desha të ëndërroj
Përse kaq herët trokasin qukapikët
Në drurin e jetës sime

Sonte kam të ftohtë
Më ngrihet kujtesa e kahershme
Si të ngrohem në këtë boshllëk
Kur duarve të mia
Kurrsesi s’mund t’ua gjej vendin

LARG MBI NJË KEP TË VETMUAR

Njerëzit gjithmonë presin te portat
Ose te dritaret e hapura
Presin të nesërmen
E cila nuk dihet se ku e humbi rrugën

Presim me padurim rritjen e plepit
Ose fluturimin e pulëbardhës
Kurse në horizont
Shihet haptazi se si fundosen anijet

Sa herë që na premton koha
Ulemi në brigjet e fantazisë
Dhe i fusim këmbët

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Në parzmën e plagosur të detit

Në çastin kur e ndjejmë urinë
Si peshku i ngordhur
E hapim gojën
Sa çel e mbyllë sytë e përpimë detin

Larg mbi një kep të vetmuar
I shikojmë sirenat
Shikojmë se si vallëzojnë
Me dallgët e trazuara të bunacës

POR GJITHËSESI ISHTE NJË DITË

Thonë se në fillim
S'kishte asgjë për çfarë mund të flasim
Ishte fillimi i një dite
Ose mbarimi i saj
Por gjithsesi ishte një ditë
E cila do mbahej në mend

Ajo mbante në dorë një trastë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Përqafonte si foshnjën
Nuk e pyetëm se nga vjen
E ku shkon
Kryesore e mbante trastën e grisur
Nga e cila shpërndahej dheu i atdheut

Sa herë që kishte mundësi
E arnonte me lëkurën e saj të grisur
Herë qeshte e herë qante
Nga sytë e saj të gështenjtë
Si shirat e vjeshtës
Binin gjethet e fishkura të një stine

Thonë se në fillim
Ishte një fillim
I tejdukshëm pa shije dhe ngjyrë
Në një pemë përballë faltores
Qante një kryq i vetmuar
Qante si një kërthi i lënë amanet furtunës

SA HERË QË I HAPIM DRITARET

Kur netët tona të pagjumë
U ngjajnë maktheve
Mëngjeset zgjohen tepër herët
Zgjohen
Me këmisha të hekurta

Jashtë në oborrin e shthurur
Dëgjohet një zë baritoni
Dëgjohet si thëllim i pasosur

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Era mbi çatitë e lejlekëve
Luan një valle të lashtë baritore

Ky dimër sivjet paska vendosur
Me na e ngri lotin në sy
Te portat e vjetra
E zbraza trastën me tërshërë
Sa ora erdhën pëllumbat e egër

Në këtë janar
Po pjalmon një acar i paparë
Sa herë që i hapim dritaret
Dëgjojmë britma njerëzish
S'pushojnë as ulërimat e ujqërve

NJË ZË QË VJEN NGA LARG

Sa herë që ndjej ngacmimin
E aromës së trëndafilit
Më del parasysh
Një asociacion i adoleshencës
Që i ngjan me flokët e saj të argjendta

Lumëbardhi dhe era më pastaj muzika
Një zë që vjen nga larg

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Si buzëqeshja e pranverës
Sa që po më duken këto imazhe
Si zgjimi i zambakëve në dimër

Te këmbët e kalasë
Nën faltoren e pamposhtur
Janë përkulur deri në tokë ushtarët
Mu ashtu siç u përkuleshin
Djemuria e lagjes hijes tënde

Tani më është dimër
Askush nuk troket në dritaret e erës
Ti mbete diku larg
Me ëndrrat dhe makthet e tua
Mbete si një sfinks në shkretëtirën e vetmisë

ZËRAT E PAKUPTIMTË NË NJË GJUHË TË HUAJ

Sa më duken të huaja sonte
Zërat e luleve
Më duken si disa tinguj që dalin nga Ferri
Një hije e verdhë
Gjatë tërë kohës luante me pantomimën

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ne nuk ishim askund
Në gjeografin e mendimit
Nëpër xhepat tona i fshehëm pasqyrat
I fshehëm edhe duart e lodhura
Menduam se kanë nevojë për pushim

Ishte një kohë e egër dhe e shthurur
Mes luleve këndonin korbat
Kurse nëpër qiellin e Kosovës
I dëgjonim krakëllimat e çafkave
I dëgjonim edhe disa lloje zërash

E gjithë kjo ngjante një llamarine
Të ndryshkur në shiun e vjeshtës
Zërat e pakuptimtë në gjuhë të huaj
Lënin një shije të hidhur
Mbi kalldrëmet e lashta ilire

MË DUKET SE TRAZOHESHIN RETË ALEGORIK

Sa herë që i zbritëm ëndrrat
Nga shkallët e kujtesës
Binte shiu imcak
Më duket se trazoheshin retë alegorike
Ua ndërronim vendet edhe mjegullave

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ishte një kohë mes adoleshencës
Dhe rinisë
Koha e cila nuk njihte askënd
Përpos forcës së imagjinatës
Tërë ditën kalonim te shelgjishtet e lagjes

Më duket se u ngjanim perëndive
Nëpër xhepat tona të arnuara
I fshihnim letrat e dashurisë
Kur vinte mbrëmja
Ndoshta nga një frikë e panjohur i grisnim

Që sërish të nesërmen
Të rifillojmë me zarfet e kaltra
Që i ngjanin
Qiellit të robëruar të atdheut
Por ne prapëseprapë nuk ndaleshim

NE GJITHMONË MENDOJMË

Gjergjin asnjëherë nuk e shoh

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Mbi një kalë të metaltë
Por duke i kalëruar kuajt e luftës
Prej një beteje në tjetrën
Hynte aq burrërisht
Sa që u bënte ballë rrufeve

Ne gjithmonë mendojmë
Se heronjtë tanë nuk plaken
Parasysh e kam fotografinë e Ademit
Atij burri me nam
I cili më shumë se atdheun
E donte kondakun e pushkës

Më kujtohen edhe trimat të tjerë
Hipur mbi rrufe të egra
Më kujtohen se si i kalëronin
Kuajt e egër
I kalëronin me shpatat e atdheut
Që s'donin të dinin për moshë

MË NDJENI O MIQ

Nuk mund të them asgjë
Nuk di a jam në gjendje
Si njeri

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ta dëgjoj muzikën e luleve

Këtë më së miri e bënë
Shpirti delikat i pranverës
Në shtatin e saj
Rriten të gjitha lulet edhe ato të lirisë

Unë paskam mbetur i shkretë
As në ëndrrat e mia
Nuk mund ta dëgjoj atë muzikë
Që buron nga shpirti i petaleve

Më ndjeni o miq
Nuk kam se çfarë të bëj
Më janë topitur shqisat
Sa që s'e ndjej as frymëmarrjen time

QË NGJAN ME PERËNDITË E OLIMPIT

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Qëndroj mbështetur për rrapin
Me trastën time të grisur
Në të cilën e mbaja bukën e përditshme
Dhe pak argjilë nga atdheu

Në mendje e kisha njeriun
Dhe formën e tij të përkryer
Po atë njeri
Që ngjan me perënditë e Olimpit

Por për fatkeqësinë time
Nuk isha në gjendje të gatuaj bukën
E jo më ta zë brumin
Për përsosmërinë e njeriut

Sëpata më shikonte me xhelozi
Dhe dikur vonë më tha
Kur s'je në gjendje ta gatuash njeriun
Nga shpirti i rrapit gdhende qivurin tënd

Prishtinë, 6 janar 2017

Cikli i dytë
Dimri ishte i kaltër

POR AS KËTO FJALË NUK MJAFTOJNË

Nuk kam letër tjetër

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Përpos kësaj kartoline
Pëllumbat mi vranë në kuvli
Nuk di pas kujt mund të t'i dërgoj

E di që nuk i ngjan zarfeve të kaltra
Ty të pëlqen kaltërsia e qiellit të Kosovës
Kurse unë nga këtu
S'mund të të shkruaj asnjë fjalë

Kjo kartolinë e kaltër
Ka aq pak vend
Sa që mund t'i shkruaj vetëm dy fjalë
Të dua

Por as këto fjalë nuk mjaftojnë
Ne kemi shumë më shumë nevojë
Me i treguar njeri-tjetrit
Për kryqin dhe golgotën e shiut

Nuk di cila stinë ishte atë ditë
Por s'ishim në gjendje të gjejmë asnjë lule
Kurse nga druri i gozhduar
Çurgonte gjaku i së nesërmes

DIMRI ISHTE I KALTËR

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Asnjë kopsë nuk kishte
Në xhaketën e saj të verdhë
Atë ditë
Dimri ishte i kaltër
Sa shumë i ngjante qiellit
Të fëmijërisë sime

Nëpër fushat e mëllenjave
I mbolli kopsat
Të nesërmen mbinë disa lloje fustanesh
Nga xhaketa ime e murrme
Dolën fluturat e para
Dhe fluturuan drejtë ardhmërisë

Më duket se ishte e diela e fundit
Të muajit shkurt
Atë ditë nuk bleva asnjë palë pantallona
Çmimet e larta marramendëse
Ma ndërruan mendjen
Ndoshta i blej njëherë tjetër

U FUNDOS NJË BOTË E TËRË

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Dikur vonë pas njëqind viteve
Kuptova se tinëzisht
Isha fundosur në sytë e tua
Isha mu në ato brigje
Ku lahej hëna lakuriqe

Nuk mjaftoi vetëm kaq
Kaltërsia e imazhit
Mi mori mentë
Sa që kurrë më
Nuk e pashë këndelljen e diellit

Kaluan edhe njëqind vite të tjera
Asnjë ndryshim nuk ngjau
Në hartën e kujtesës
Sërish pashë që në sytë e tua të kaltra
Ende lahej një hënë lakuriqe

DIKUR VONË PJALMOI MOLLA

E KUQE

Ku ishe ti kur ulërimat e natës
Ia shqyen astarin e qiellit
Atë ditë në kopsht
I dëgjova edhe lehjet e drurëve

Binte një shi i rreptë
Në imagjinatën tonë të shthurur
I shkulëm drurët deri në rrënjë
Dhe asnjë gjethe nuk lamë nëpër degë

Kopshti i ngjante një arene
Ku dukej se është luftuar me qindra vite
Çuditërisht pemët ishin të lumtura
Disa hoje bletësh këndonin në kor

Dikur vonë pjalmoi molla e kuqe
Njerëzit filluan të këndellen
Thonë se atë ditë u këndua deri në ag
Ishte një ditë që lindte për herë të dytë

KUR POHUAN TË LIGËTIT

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Kur pohuan të ligëtit
Se vdiq Kosova
Unë mu atëherë besova
Në lindjen e saj

Nga perspektiva ime
Ajo dukej si një nuse e përgjakur
Por krenare
Si asnjëherë më parë

Ecëm edhe njëqind vite
Rruga ishte gjatë
Por ne mbërrimë me djemurinë
Në dasmën e saj të parë

Kur pohuan të ligëtit
Se ne përfundimisht mbaruam
Unë atë ditë ndjeva forcën e Hyjit
Dhe kalërove mbi rrufet e zjarrta të atdheut

PA DITUR SE PËR CILËN KOHË

Jemi në një gjendje
Kur nuk dimë
Ose nuk duam t'i kuptojmë
Të bëmat tona
Por fjalët na janë katandisur
Sa që s'merremi vesh as me vetveten

Shkruajmë poezi të shthurur
Pa thënë asnjë fjalë
Mendojmë se e thamë të tërën
Çfarë u deshtë të themi
Kurse të tjerët na e përqeshin
Kokëfortësinë tonë

Me nga një libër ndër sqetull
Shëtisim të vetmuar shëtitoreve
Na përshëndesin përmendoret
E ne me sy të kallkantë
Shikojmë të nesërmen e dyshimtë
Mbase nuk i besojmë as vetvetes

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Secilën poezi që shkruajmë
Mes rreshtave
Pa ditur se për cilën kohë
Lëmë nga diçka prej shpirtit tonë
Lëmë si peng
Fjalën e pathënë asnjëherë

U PUTHËM NË TELAT E KUJTESËS

Më duket se nuk të thashë
Se cila ditë ishte kur u pamë
Ne ishim dy të huaj
Dy krijesa
Unë me gabimet e mija të pafundme
Kurse ti i ngjaje engjëllit

Të nesërmen ngjau ajo
Që duhej të ngjante para njëmijë viteve
Si dy zogj
U puthëm në telat e kujtesës
Më duket se kaq ishte për ditën e parë
Kurse të dytën ditë e vramë njëri-tjetrin

Mbase kështu paska qenë gjithmonë
Për çdo ditë ujërat grafulluan
Bymehej ajri përreth nesh

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Bymehej si kitara e tendosur
Aq bukur këndonte era
Sa që i këputi të gjitha telat

MË VËSHTRO SI LUMIN E NGRIRË

Prekmi këto rrudha në duart e mia
Pastaj mos i anashkalo
As thellësinë e syve të gështenjtë
Zhytu si në shpirtin e Adriatikut
Dhe lexo me vëmendje
Të gjitha parathëniet e shkruara

Vështro se si të shikojnë
Drejt në sy
E njohin për mrekulli
Alfabetin e Morzeut
Me qindra vite belbëzuan në heshtje
Vështro se sa madhërishëm të shikojnë

Sot jemi me shtatë janar

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Më vështro si lumin e ngrirë
Që nga koha biblike
Akujt e shpirtit
Asnjëherë nuk shkrihen te njerëzit
Më vështro si lumin e ngrirë
NË NJË KOPSHT EKSPERIMENTAL

Në fillim nuk kishte asgjë
Përpos mjegullave
Pastaj si në ndonjë përrallë
Filluan të lindin perënditë

Lumenjtë dukeshin të skuqur
Po ashtu edhe barit
I mungonte gjelbërimi

Një pemë e egër
Që rritej në shtrojerë
Nuk ngjante me pemët e sotshëm
Kishte dy duar dhe dy sy

Nga gjoksi i saj i mbufatur
Buronin lumenjtë e çmendur
Ishte koha
Kur dëgjoheshin shtërzimet e maleve

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Më pastaj u paraqit njeriu
Dolën në shesh
Edhe të gjitha të ligat e tij

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Në një kopsht eksperimental
Nga duart e një zonje
Tinëzisht e grabiti mollën e egër
Dhe kurrë më nuk u ndalën kafshimet
KUR U KRIJUEN DETET

Duke i kërkuar duart nëpër mjegull
I prekëm eshtrat e një kohe
Shiu ishte tërë trishtim
Vetëtimat i binin telave të rrufeve

Nga të katër anën e qiellit
I pamë kuajt e egër
Dyndjet e erërave
Me vite të tëra nuk pushuan

Më duket se ishte ditë e shtunë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Kur u krijuan detet
Lindën edhe brigjet
Nga dhembjet e shtërzimeve u thye hëna

Një copë porcelani ra në tokë
Atë ditë dielli shkëlqeu për herë të parë
Për herë të parë e pamë
Buzëqeshjen e pandalshme të barit
TË THASHË MË VËSHTRO ME KUJDES

Brenda meje nuk banojnë më
Fluturat e natës as lakuriqët
Vështromë pakëz më mirë
Në thellësinë e shpirtit tim
Ka vend për çdo njeri

Të thashë më vështro me kujdes
Asnjë lugat nate

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Nuk bredh nëpër qenien time
Jam njeri si të gjithë njerëzit
I cili ndjen frymëmarrjen e barit

Sërish po të them kij kujdes
Kur e shkruan ditarin tënd
Na lërë pak vend
Për mua dhe fluturat e ikura të ditës
Edhe ne kemi nevojë për frymëmarrje
MIKU IM I KATIT TË DYTË

Miku im nuk ka shumë dëshira
Të vetmen që e ka
Të ngjitet deri në kati i tretë
E të trokas
Në portat e kujtesës

Sa herë që gjendet te shkallët

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Fillon e bie një shi alegorik
Andaj
Pa ombrellën e tij të çuditshme
Asnjëherë nuk troket te dera

Miku im i katit të dytë
Më duket se gjithmonë ëndërron
Katin e shtatë të qiellit
Sepse beson shumë që një ditë
Do të takohet me engjëllin e mirë
KORBAT PËR ÇDO MBRËMJE

Atë ditë perdet ishin lëshuar
Deri në podium
Askush nuk e mbylli teatrin
Një grup aktorësh
Me një ngjyrë të portokalltë
Ngjyronin aktin e parë të trishtimit

Nëpër qytet çfarë nuk flitej
Një dukuri e rrallë
Pëshpëritej nëpër tavernat e lagjeve

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Flitej se autori kryesor
Ende pa e përfunduar pjesën tragjike
Kishte bërë vetëvrasje

Perdet kurrë më nuk u ngritën
Ditën e kafshoi mola
Aktorët u bënë pikë e pesë
Filloi të pikonte edhe çatia
Korbat për çdo mbrëmje
Krakëllinin në një kor të çuditshëm
Prishtinë, 7 janar 2017

ISHA NJË NJERI PA SHTET DHE ATDHE

Kudo që isha
Lashë nga një pikë lot rrugëve
Për dolli gjithmonë ngrita gotën
Në emër të atit
Të shpirtit dhe të atdheut

Në shtëpinë e prindërve të mi
Ndjehesha i huaj
Përdorsha një tjetër gjuhë
Flamuri im
Për mua ishte një nocion i ndaluar

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Si një top prej lecke
Me gjuanin prej një vendi
Në një tjetër vend
Nuk askurrë
Se ku më ishin varrosur gjyshërit

Atdheun e kisha në rrugë
Pranë kopshtit të ndaluar
S'guxoja të shkundi asnjë mollë
Më thanë të huajt ardhacakë
Se jam një njeri pa atdhe

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

I shikoja flamujt e të tjerëve
Se si valonin për festat shtetërore
Kurse krenaria ime fundosej në mua
Isha një njeri pa shtet e atdhe
Por dykrenorin kurrë nuk e harrova
KËSHTU E NDJENIM VETEN VETVETJA
E JONË

Kur e dëgjova vajin tim
Kuptova se isha në një tjetër botë
Askush nuk më pyeti
Kush jam dhe nga cili yll pikova

Me kohë e mësova gjuhën
Komunikoja edhe me njerëzit
Besa e mësova për mrekulli pantomimën
E vetmja gjuhë që më mbajti gjallë

Thuaj se në lagjen time
Shtatë gjuhë flitej

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Për çudi nuk na pengonte asnjëra
Përpos yllit pesëkëndësh

Dhe u rritëm mes lumenjve
Edhe këmishët i kishim prej gjetheve
Brenda një kohe të shkurtër
Komunikonim në disa gjuhë

Më kujtohet fare mirë
Secili prej nesh qante dhe shante
Vetëm në gjuhën e vet
Kështu e ndjenim veten vetvetja e jonë

ISHTE NJË KOHË MES STINËVE

Deti i trazuar i kishte puthjet e njelmëta
Hëna atë çast dukej
Si një top i gjysmë skuqur
Mua më kafshonte acari
Kurse ajo i krihet në breg
Flokët e saja të mëndafshta

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Nuk ishte dimër
Por s'ishte as stina e vjeshtës
Ishte një kohë mes stinëve
Ku vetëm ato ditë
Piqeshin pemët bregdetare
Për marinarët e dehur nga dashuria

Kur vinin mjegullat ne për mrekulli
I kuptonim shqetësimet e shirave
Me një ombrellë prej letre
I mbulonim pemët në kopsht
Dhe me kashtën e ndezur
I mbronim nga dëmtimet e brymës

KURSE SAZEXHIU SHIKON PUNËN
E VET

Sa herë që zgjohemi
Së pari na bien ndërmend ëndrrat
S'mendojmë për mëngjesin
As për kërcimin e gjelit
Prej një trari në trarin tjetër

Për makthe kurrë nuk flasim
Me një krehër druri
I krehim trishtimet e natës

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Dhe më pastaj
Përshëndesim njerëzit në rrugë

Posa e hapim dritaren
Në dhomë hynë ngjyrat e portokallta
Të diellit mëngjesor
Pa u zgjuar agimi
Ndjejmë aromën e kositur të barit

Dikur vonë si zakonisht
Ndalemi në pijetoren e parë të lagjes
Flasim me miqtë për sportin
Dhe politikën ditore
Kurse sazexhiu shikon punën e vet

ATË DITË PRISHET MOTI

I habitur shikoj qiellin e sterruar
S'është dallgë deti

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

S’janë as mjegullat e plumbta
Por këto re të zeza
Sa shumë po u shëmbëllejnë çafkave

Thonë se kur fluturojnë
Si shtëllungat e mjegullave
Atë ditë prishet moti
Ose martohen korbat e bardhë
Me çafkat e zeza

Kështu kam dëgjuar prej pleqve
Ndryshe s’ka se si të prishet moti
Edhe sorrat e tjera
E të gjitha llojeve fluturojnë
Derisa përfundon kjo dasmë sorrakësh

U DËGJUAN EDHE ULËRIMAT E
RRËNJËVE

Për herë të dytë dola në shtegun e vjetër

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ishte dita e parë e dimrit
Acari kafshonte gurin e murrmë
Nga dhembja
I ndjeve ulërimat e drurëve

U dëgjuan edhe gjëmat e rrënjëve
Rrapi i vjetër me xhelozi
Bisedonte me plepin për djepin tim
Kjo bisedë rasti
Më duket se s'kishte të përfunduar

Nata e sterrët i ngjante njeriut
Me shkop të bardhë
Asnjë flutur nuk fluturonte
Nëpër monopatet e kujtesës
Dielli atë ditë veç kishte perënduar

ATA E HARRUAN VETVETEN

Ata harruan dhembjen
I harruan edhe flamujt e luftës

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Sot flasin kot për patriotizëm
Leku është kryqi dhe flamuri i tyre

I harruan plagët e luftës
Bukën e gatuar me lotët e nënave
Nuset e dhunuara
Dhe motrat e ngulura nëpër hunj

Mbase e harruan edhe vetveten
Harruan duke ngarendur si pretarë
Parakalojnë të shthurur rrugëve
Dezertorët e të gjitha luftërave

Ata e harruan vetveten
Në politikë dhe biznes është fitimi
Harruan që dje ishin luaj të patrembur
Kurse sot u shndërruan në minjtë e gjirizeve

E SHIU I MARSIT TË ÇMENDUR

Ne nuk kemi se çfarë të ju tregojmë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Në një mënyrë ishim dezertorë
Një mbrëmje na ngarkuan në tren
Dhe sa ora arritëm në Bllace

Si sot më kujtohen britmat dhe piskamat
Vajet e traversave
Gjëmat e metalta të binarëve
Dhe këmisha e tmerrit që e bartnim

Më kujtohet edhe shiu kur mbërrimë
Në lëndinën e trishtimit
Lotët e vëllezërve nga Pollogu
Që na pritën me bukë e qumësht

Oh sa shumë më kujtohen ankthet e mia
Fluturimet e zogjtë të metaltë të shpresës
Kurse shiu i marsit të çmendur
Nuk kishte të ndalur atë ditë

SHISTE EDHE KUNGUJ TË PJEKUR

Kam dëgjuar se ishte koha e vdekjeve
Bota ishte çmendur
Mbante në dorë kosën e vdekjes
Një kalë i egër
Shqelmonte rrapin që s'dorëzohej

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Thonë se ishte marsi i hershëm
Sepse mu ato ditë vijnë shirat
Pranvera ende s'kishte filluar
Ishte fundi i një dimri të acartë
Dhe fillimi i një shtërzimi të ri

Askush nëpër rrugët e qytetit
Aletë e boshatisura
U ngjanin korbave të lagur në shi
Vetëm çizmet e zeza
Parakalonin të vetmuara shëtitoreve

Një njeri me një pallto qesharake
Mbante në duar disa lloje flamurësh
Më duket se ishte shitësi i simiteve
Shiste edhe kunguj të pjekur
Mbase ishte një kohë kur s'blihej vetëm jeta

KJO AMNEZI PËR TË KALUARËN

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ka shumë vite
Që nuk arrita të shkruaj një letër
Nga qyteti im
Të shkruaj për miqtë që nuk ekzistojnë
Kurse të gjallëve ua kam harruar emrat

Si kripën më treti kjo largësi
Nuk më kujtohet as fëmijëria
Shejtanllëqet duke i shkundur pemët
Ende pa u pjekur
Dhe si na ndiqte xhaxhai nëpër kopsht

Vjedhjen e vezëve nëpër kotece
Asgjë nuk më kujtohet
Kjo amnezi për të kaluarën
Mbase i ka rrënjët diku tjetër
I ka rrënjët nëpër xhepat e adoleshencës
PAS MALIT DËGJOHEN KRISMAT E PUSHKËVE

(Diku në front)

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ti përqafon kondakun
Ai këndon këngën “Vijnë vaporët moj nënë”
Kurse një biondine
Shkruan letër të dashurve të saj

Acari i pamëshirshëm
Nuk paska të ndalur sonte
Pas malit dëgjohen krismat e pushkëve
Të përziera me britma e armiqsh

Këtu në fronte nuk ka dimër
Na ngrohin krismat dhe piskamat
Ajo ende shkruan letër
Më duket se është letra e tretë e saj

Kondaku i pushkës vezullon
Sa që ua merr sytë armiqve
Një këngë e lashtë sërish dëgjohet
Mbi varrin tim mos vajto moj nënë

JAM NJË ZBRAZËTIRË E PAFUND

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Vështroni si duhet
Brenda meje nuk ka asgjë
Jam një zbrazëtirë e pafund
Këto duar nuk ngjajnë me duart e njeriut
Shikoni se sa shumë ngjajnë
Me degët e thara të gështenjës

Sa herë që i zgjati deri te pemët
Si dardhat e kalbura
Më shkunden mendimet
Vështroni këtë zgërbonjë
Në gjoksin tim
Është aq i thellë sa që fundosen anijet

Nuk di më se kush jam sot
E kush isha dje
Atë ditë që më vdiq kujtesa
Më thanë se emri im quhet harresë
Andaj sot jam një njeri i rrugëve
Bredhi mes kontejnerëve të ndryshkur

MBETA DIKU NË MES TË RRUGËS

Duart e mia kaq delikate
U mbytën në gjoksin tënd

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Atë ditë
Dielli ishte fundosur
Thellë në parzmën e tokës

Era lëronte nëpër mjegull
Shiu i çmendur binte mbi ullukët e lagjes
Asnjë lejlek nuk pashë nëpër oxhaqet
E shembura
Ishin këputur edhe telat e telefonave

Mbeta diku në mes të rrugës
S'dija kah t'ia mbaj
Lindjen nuk e desha asnjëherë
Kurse perëndimi
Kurrë nuk mi ledhatoi flokët

Kështu mbeta rrugëve
Tok me shiun e baltosur
Në anën e majtë laheshin zogjtë në pluhur
Kurse në anë e djathtë
Më shkelnin ingranazhet e tankeve

Prishtinë, 8 janar 2017

Cikli i tretë
Kush na i vodhi ëndrrat

NJË VALLE E LASHTË PAGANE

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Stoli njeriu dhe gota gjysmë e thyer
Në mur përballë kujtesës
Dëgjohen vajet e ikonave
Me ngashërim qanë edhe korridori
Asnjë njeri
Nuk mund ta ngushëllonte erën

Pijetorja si në çastet e mortjes
Kishte ulur kokën
Shikonte në dyshemenë e lagshtë
Vallen e bubuzhelëve
Një njeri në këndin e djathtë
I kafshonte thonjtë

Sërish një heshtje
Dajrja dyqind vjet nuk dëgjohet këtu
Evgjitët paskan harruare të dehen
Një valle e lashtë pagane
Sapo ka filluar
Të ringjallet në fushat e mëllenjave
VASHAT ME SHAMIA TË LARME

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

I mbylli sytë
Një shtator i largët më del përpara
Si kokrra e syrit të vashës
Duket rrushi i pjekur i Kosovës

Ishin ato ditë me diell
Kur i kallajisnim kazanët
Gjinkallat veç ia kishin filluar këngës
Nëpër vreshta s'pushonin zurnatë

Po ai shtator i dikurshëm
Me tërë imazhin e tij
Parakalon nëpër mendjen time
Parakalon si një mbret i pathyeshëm

Nga kokrrat e rrushit pikon mushti
I dashurisë
Vashat me shamia të larme
Hijeshojnë bregoren në horizont

NËSE TAKOHEMI PAS VDEKJES

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Më prit te portat e kujtesës
Më pritë tok me qeshjen tënde
Dielli i acartë kaherë
Paska kaluar këndej pari

Sa shumë kohë që s'u pamë
Unë dola nga lëkura ime
Kurse ti duke i krehur flokët
E harrove pikëtakimin tonë

Tashmë është tepër vonë
Ta kthejmë rrjedhën e ujit
Jemi të lodhur nga rruga e gjatë
Fluturat e mëngjesit veç kanë ikur

Ndoshta ndonjëherë tjetër
Do i prekim gishtat njëri – tjetrit
Po që se takohemi pas vdekjes
Se kështu për së gjalli jemi të vdekur

KUSH NA I VODHI ËNDRRAT

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Mos m'i prekni ëndrrat
Gati njëqind vjet nuk e pamë ylberin
Ishte një kohë e shthurur
Mjegullat orë e çast ishin pa itinerar

Më kujtohet kur vinin
Ose shkonin shirat
Vjeshta dukej lakuriqe
Asnjëherë nuk kishte këmishë nate

Sot është ditë e premte
Portat e pasme të kishës
Kurrë nuk mbyllen të shtunave
Rrinë hapur për meshën e së nesërmes

Pëllumbat veç paskan ikur
Më duket se mbrëmë iku edhe nata
Afër njëqind vjet jemi pa gjumë
Kush na i vodhi ëndrrat

KEMI QENË AQ TË LUMTUR

Më përqafo e dashur
Më shtrëngo fort për trupin tënd
Më prek me shikimet e tua
Vetëm kështu
Mund të largohen ankthet e mia

Më kupto kam dhembje
Po më dërmohen këto kocka të lodhura
Ja kështu afrohu
Vështro në thellësitë e syve të mi
Shko deri atje ku mund ta takosh vetveten

Ne jemi një ngjizje e pandashme
Shiko se si nga sytë tanë
Burojnë lumenjtë e pikëllimit
Kësaj i them unë dashuri
Ata që nuk vuajnë s'dinë as të dashurojnë

Të kujtohet kur ishe mbrëmë
Në ëndrrën time
Kemi qenë aq të lumtur
Sa që kurrë s'ka qenë kështu
Në zhgjëndrrat tona të përditshme

Prishtinë, 9 janar 2017

KREJTËSISHT NË ANËN E KUNDËRT TË URREJTJES

Sërish kjo botë lakmitare
E ngarkuar me hallet e veta
Ku diku lindin njerëz të gjymtuar
E diku tjetër
Vdesin pa kurrfarë emri
Duke vrapuar pas bukës së përditshme

Shiko dhe përcille mirë
Deri në fund të rrugës
Fluturimin e kaltër të kësaj fluture
Me qindra lule i pamë në jetë
Por kjo pamje në krahët e kësaj krijese
Është ajo lule që quhet dashuri

Shumë pamë dhe po aq
Do të shohim në jetë
Kur fluturojnë
Dy flutura të dashuruara
Fluturojnë prej një ane

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Krejtësisht në anën e kundërt të urrejtjes

SA TË KALTRA I PASKE SYTË SONTE

Nuk kam më takat
Që të qaj sonte
Në sytë e tua të kaltra
Dua ta pikturoj dashurinë

Më besoni
Çdo gjë është e kaltër
Edhe guri i murrmë
E ka kaltërsinë e syve të saj

Luadhet janë të kaltra
Ngjajnë me imazhet e detit
Kur dashurojnë sirenat
Çdo gjë sonte është e kaltër

Të kaltra i kemi fjalët
Edhe më të kaltra janë përqafimet

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Sa të kaltra i paske sytë sonte
Dashuria ime e kaltër

SA E BUKUR DO TË ISHTE KJO
VDEKJE

Ku na mbetën ëndrrat tona
Në cilën kornizë i vendose kujtimet
Kjo ikonë e kujtesës
Njëqind vjet do jetoj mes nesh

Më mbaj për dore
Se përndryshe do të fundosem
Në baltën e gjallë
Sa e bukur do të ishte kjo vdekje

Të lutem ndalu pak

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Pikturo në mendje këto çaste lumturie
E kur të marrim udhë
Të kemi se për çfarë të bisedojmë

TI KURRË NUK MË BESOVE

Çdo prekje e jote
Ka nga një gjurmë mbi lëkurën time
Ne u takuam në fund të marsit
Kur veç kishin çelë lulet e para

Dhe asnjëherë më nuk patëm dimër
S'patëm verë as vjeshtë
Gjithmonë ishte pranverë
Në rrugëtimin tonë të gjatë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Të kam thënë se një ditë
Do ta shkelim pragun e dimrit
Ti kurrë nuk më besove
Shiko pra se sa na janë zbardhur flokët

NDIZE STUFËN E AKULLT TË DHOMËS

Si lisat u gjunjëzuam edhe ne
Vite e vite bartëm dashurinë
Mbi shpatullat e lodhura
Tani as dielli nuk po i ngroh
Mendimet tona të ngrira

Ikën motet e kohërave të mira
Kjo pjalmim dëbore
Na ka hyrë në çdo kockë
Secilin hap që po e hedhim
Po na e zë frymëmarrjen

Ndize stufën e akullt të dhomës
T'i ngrohim eshtrat e ngrira
Dikur vetëm nga shikimet e ngrohta
Shkriheshin kallkanët
Kurse sot hejet po na i shpojnë sytë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Kam të ftohtë kudo acar rreth meje
Më përqafo të ngrohem pak
Më përqafo si dikur
Në frymëmarrjen tonë të shpeshtuar
Kam mall t'i shoh djersitjet e mureve

TË LUTEM MË MBAJ PËR DORE

(Varianti i dytë)

Të marrtë e mira moj
Mos më shiko si dikur
Edhe ty të janë lodhur sytë
Asgjë nuk është më siç ishte dje
Shiko se si pjalmojnë vitet
Në thinjat e këputura të flokëve

Të marrtë e mira moj
Më mbaj për dore
Ne jemi në fund të rrugës
Më mbaj fort
Të mos më mbështillen këmbët
Si mendimet e shthurura

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Po të them më mbaj sa më fort
Po lëkundem si lisi plak
Nuk më mbajnë as këmbët
Vetëm dora e jote
Më mban në këmbë
Të lutem më mbaj për dore
Të marrtë e mira moj
KAM NEVOJË TË MBËSHTETEM

(Varianti i tretë)

Sot paskam më shumë nevojë
Për dorën tënde
Më mbaj të lutem
Kam nevojë të mbështetem
Edhe për hijen time

Ky acar dimri
Po e kafshon moshën time
Të thashë më mbaj
Se nuk më mbajnë këmbët
Për ku të mbështetem nëse jo për ty

O më mbaj se e theva qafën
Kjo rrugë e kallkantë
Po mi ngrinë edhe këpucët
Palltoja ime e vjetër
Po i ngjan veleve të anijeve lugetër

ME CILIN VALS

Më trego të lutem
Athua je ti
Ose gota e mbushur me raki
Këtë këngë që po e dëgjoj
Ishte dikur himni
I një dashurie të papërfunduar

Je ti pranë meje siç dikur
Ose vegimi im
Shndërruar në hije
Më thuaj të lutem
Me cilin vals

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Ta mashtrojmë natën

Ky dimër që paska zbritur
Në shpirtin tim
Po ma ngrinë gjakun
Në damarët e mi të plakur
Më trego të lutem
Përse kaq vonë troket në xhamat e kujtesës

NUK KA LAMTUMIRË MES MIQVE

Nuk dua të ju them lamtumirë
Ne gjithsesi
Do shihemi një ditë
Sonte mos më prek të lutem
Më lë të pushoj në stolin tim

T'i dëgjoj me afsh
Këngët që i këndonte Vaçja

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Sidomos këngën
Shqipëri moj nëna ime
Të dëgjoj derisa më mbanë frymëmarrja

Nuk ka lamtumirë mes miqve
Ju thashë se ne një ditë
Domosdo do të takohemi
Do pimë edhe njëherë
Gllënjkën e fundit të pikëllimit

NË EMËR TË KUJT TË DEHEM SONTE

Mos mu paraqit sonte
Nuk jam vetëm
Me mua pranë këtij stoli
Është një gotë e thyer
Dhe gllënjka e stinëve të ikura

Dua të dehem me kujtime

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Te dehem aq shumë
Sa që nga thinjat e flokëve
T'i zbres njëherë e përgjithmonë
Të gjitha shtrezet e dynjasë

Pranë meje gota e thyer
Dhe një kornizë e vjetër
Mbështetur për murin e lagshtë
Në emër të kujt të dehem sonte
Të dashurisë apo të dhembjes

FLUTURUAM DERI TE ÇERDHJA E DASHURISË

Letrat e tua të bardha dhe të kaltra
Kurrë nuk i lexova
Çdo fjalë thithja nga sytë e tua
Thithja si bleta
Që e thith nektarin prej luleve

Mua asnjëherë nuk më kanë pëlqyer
Fjalët e mëdha
Nga gjërat e imta gjithmonë
Lindin veprat të mëdha monumentale
Siç është dashuria

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Po e përsëris për herë të dytë
Të kujtohet puthja
Në minaren e xhamisë së Sinan Pashës
Që të dy ne si në kor
Atë ditë e prekëm dashurinë me dorë

Ishim njëzet e ca metra mbi tokë
Ishte një puthje e papërsëritshme
Mu duk se në ato çaste
U ngjanim zogjve të qiellit
Fluturuam deri te çerdhja e dashurisë

PA POROSITJE TË ZAKONSHME

Ajo për çdo ditë
Vjen në qytet me një kapelë të re
Dhe pantallona të zeza
Ka një çantë të kuqe
Dhe dy pasqyra të tejdukshme

Përreth beli mbanë një rrip të bardhë
I imiton pëllumbat në fluturim
Sa herë që ndalet në kafenenë te plepat
Pa porositje të zakonshme
Kamerieri ia sjellë kafenë farmak

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Në pasqyrën e parë i kreh flokët
Kurse në të dytën
Kush e di se për të satën herë
I lyen buzët
Me disa lloje të buzëkuqeve

Dikur kah mbrëmja
Kur tavolinat duken të zbrazëta
Ajo ngritët në këmbë
Si një bibë e majme për kërshëndella
Ecën duke u tulatur rrugëve

DRIDHEN DRURËT GJEMBOR

Me hapa të lehta kalon trotuareve
Takat e saja
Formojnë një muzikë të lehtë
Duke ecur rrugëve
Dridhen drurët gjemborë

Me çantën e saj të portokalltë
Krekoset si këndesat
Ndonjëherë këndon nën buzë

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Këngën e saj të preferua
Ave Maria

Nuk është e panjohur në lagjen tonë
Të gjithë e dinë për mrekulli
Historinë e saj
Por askush nuk di se nga erdhi
Dhe ku do të iki nesër

Për çdo ditë i ndërron fustanet
Po ashtu edhe çantat
Vishet me modën e fundit
Kohët e fundit ka filluar të përdorë
Buzëkuqen e saj me ngjyrë të zezë
TE NESËRMEN LAGJA ISHTE NË ZI

Ditën e fundit kur e pashë
Shtrëngonte në dorë
Çantën e saj të verdhë
Dridhej e tëra
I ngjante një purteku të zi

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Kuptova se vuante nga një sëmundje
E pashërueshme
Në sytë e saj të zbehtë
Dallohej një hartë e hidhur e jetës
Dallohej biografia e pashkruar

Të nesërmen lagja ishte fundosur në zi
I kishte lëshuar flamujt e dhembjes
Atë e kishin vendosur
Mbi një qivur të përdorur
Dhe udhëtonte në një udhë të largët
Prishtinë, 1o janar 2017

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën “Pionieri” më 1957. Si i punësuar në

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë

1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.

2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.

3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997

5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000

6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007

9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008

11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010

28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015

114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi,

Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
128. "Rrugës qante një stërqok", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
129. "Kali im prej bore" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
130. "Përballë hijes së mollës ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
131. "Jehu i zërave", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
132. "Në kujtesën e pemëve ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
133."Më mirë një gjysmë ëndrre ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
134."Një dry prej dylli " Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016.
135." Në anën tjetër të mendjes", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
136."Sa shumë ethe pat dimri sivjet", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
137. "Enigmat e kashelashave ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
138. "Nuk i them uinë dot kësaj liri" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
139. "Fluturat prej letre ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
14O. "Fluturimi i gjinkallës", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016

141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016

142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
150.“Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
151.“Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
152.“Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Përmbajtja :

Cikli i parë
Një stuhi prej bryme

Me shtërzimin e zërit të mykur

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Vetëm zërat mjegullave
As me dizgjinët e erës
Një stuhi prej bryme
Ajo e lashtë Via Egnatia
Askund një copë tokë
Kishte vdekur edhe vjeshta
Kudo lule të këputura në shpirt
Kafshonte lëvoren e drurit
Ne nuk dashuruam asnjëherë
Ju thashë se një ditë
Kurse mbrapa si të kthehem
I pashë edhe anijet e fundosura
Deti i trazuar i shpirtit
Hiri i kujtesës
Larg mbi një kep të vetmuar
Por gjithsesi ishte një ditë
Sa herë që i hapim dritaret
Një zë që vjen nga larg
Zërat e pakuptimtë të një gjuhe të huaj
Më duket se trazoheshin retë alegorik
Ne gjithmonë mendojmë
Më ndjeni o miq
Që ngjan me perëndit e Olimpit

Cikli i dytë
Dimri ishte i kaltër

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Por as këto fjalë nuk mjaftojnë
Dimri ishte i kaltër
U fundos një botë e tërë
Dikur vonë pjalmoi molla e kuqe
Kur pohuan të ligëtit
Pa ditur se për cilën kohë
U puthëm në telat e kujtesës
Më vështro si lumin e ngrirë
Në një kopsht eksperimental
Kur u krijuan detet
Të thashë më vështro me kujdes
Miku im i katit të dytë
Korbat për çdo mbrëmje
Isha një njeri pa shtet dhe atdhe
Kështu e ndjenim veten vetvetja e jonë
Ishte një kohë mes stinëve
Kurse sazexhiu shikon punën e vet
Atë ditë prishet moti
U dëgjuan edhe ulërimat e rrënjëve
Ata e harruan vetveten
E shiu i marsit të çmendur
Shiste edhe kunguj të pjekur
Kjo amnezi për të kaluarën
Pas malit dëgjohen krismat e pushkëve
Jam një zbrazëtirë e pafund
Mbeta diku në fund të rrugës

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme

Cikli i tretë
Kush na i vodhi ëndrrat

Një valle e lashtë pagane
Vashat me shamia të larme
Nëse takohemi pas vdekjes
Kush na i vodhi ëndrrat
Kemi qenë aq të lumtur
Krejtësisht në anën e kundërt të urrejtjes
Sa të kaltra i paske sytë sonte
Sa e bukur do ishte kjo vdekje
Ti kurrë nuk më besove
Ndize stufën e akullt të dhomës
Të lutem më mbaj për dore
Kam nevojë të mbështetem
Me cilin vals
Nuk ka lamtumirë mes miqve
Në emër të kujt të dehem sonte
Fluturuam deri te çerdhja e dashurisë
Pa porositje të zakonshme
Dridhen drurët gjembor
Të nesërmen lagja ishte në zi

Adem Zaplluzha-Një stuhi prej bryme